



Projekt i financuar nga  
Bashkimi Evropian



**Save the Children**

# **Përfshirja e Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri**

***Arritjet kryesore***

# INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI PROJEKTIN


**Kohëzgjatja:** 1 janar 2017 -30 qershor 2018

**Buxheti total:** 578,833 €

## Qëllimi i projektit:

Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe organizatave me bazë komunitare (OBK), aktive në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, përmes rritjes së kapaciteteve të tyre organizative dhe menaxheriale, gjithëpërfshirjen dhe advokimin për çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

## Shtirja Gjeografike dhe Institucionale e Projektit



## PËRFITUESIT DHE ARRITJET KRYESORE

### Përfituesit e drejtpërdrejtë

**24,442**

**21,171**  
fëmijë

**3,271**  
të rritur

**9,752**

djem



**11,344**

vajza



**1,491**

burra



**1,892**

gra



Gjatë projektit janë trajnuar

**2,388**  
profesionistë



**2,482**  
prindër



### Përfituesit indirektë

**66,308**

**47,680**  
fëmijë

**18,628**  
të rritur

**23,986**

djem



**22,882**

vajza



**9,841**

burra



**9,051**

gra



# Arritjet kryesore sipas fushave të ndërhyrjes

## 1. Kontribut në Hartimin e Politikave në nivel lokal dhe qendror

- ✓ Kontribut nga “Rrjeti Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” (i krijuar në kuadër të këtij projekti i cili përbëhet nga 35 organizata të shoqërisë civile aktive në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në të gjithë vendin) me rekomandime konkrete gjatë hartimit të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara në Nenin 32, pika 1,5,6,7.
- ✓ Kontribut nga “Rrjeti Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, në hartimin e akteve nënligjore të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, në mënyrë të veçantë në VKM “Për Procedurat e Referimit dhe të Menaxhimit të Rastit, Hartimin e Përmbajtjes së Planit Individual të Mbrojtjes, Financimit e Shpenzimeve për zbatimin e tij si dhe zbatimin e Masave të Mbrojtjes”.
- ✓ Hartimi i një dokumenti advokues me rekomandime nga “Rrjeti Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” në të cilin janë paraqitur evidencime, mangësi dhe sfida të ndryshme në sistemin e respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre. Ky raport përfshin gjetje dhe rekomandime të cilat do të dërgohen strukturave të vendimarrjes në nivel lokal dhe qendror me qëllim përmirësimin e kontekstit të respektimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.
- ✓ Hartimi i Planeve Lokale të Mbrojtjes së Fëmijëve në qytetet: Kukës, Tropojë, Berat dhe Sarandë që adresojnë në nivel lokal çështjet e mbrojtjes së fëmijëve nëpërmjet një planifikimi të detajuar për fuqizimin e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve, krijimin, fuqizimin dhe shpërndarjen e shërbimeve për fëmijët si dhe rritjen e koordinimit dhe bashkëpunimit midis aktorëve.

## 2. Fuqizimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, modelimi dhe ofrimi i shërbimeve për fëmijë

- ✓ Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve të shërbimeve publike dhe jo-publike ndërsektoriale mbi mbrojtjen e fëmijëve (policia, arsimit, shëndetësia, shërbimi social, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, organizata lokale etj).
- ✓ Modelimi dhe integrimi i alternativave të përkujdesit (çerdhe dhe kopsht) në orët e pasdites për fëmijët e nënave viktime të trafikimit dhe dhunës në familje për të lehtësuar ri-integrimin e tyre dhe për një përkujdesje tërësore dhe cilësore për fëmijët.
- ✓ Shërbime me bazë komunitare parandaluese dhe mbrojtëse në 5 (pesë) qytete të ofruara në qendra ditore për fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët në rrezik braktisje shkollore (aktivitete psiko-sociale për fëmijët, klasa mësimore, këshillimi për prindërimin pozitiv, identifikimi dhe referimi i rasteve tek shërbimet publike dhe jo publike).

## 3. Rritje e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe fuqizimi i fëmijëve për të njohur, artikuluar dhe advokuar për të drejtat e tyre.

- ✓ Ngritja e kapaciteteve të fëmijëve për monitorimin e të drejtave të fëmijëve nga vetë fëmijët në shkollë dhe komunitet.
- ✓ Fushata ndërgjegjëse për komunitetin me fokus mbrojtjen nga çdo lloj forme abuzimi, neglizhimi, shfrytëzimi dhe trafikimi të fëmijëve.

#### 4. Hartimi i dokumentave për profesionistë

- ✓ Hartimi i raportit mbi "Të Drejtat e fëmijëve me prindër të burgosur në Shqipëri" i cili jep rekomandime për krijimin e lehtësirave dhe ofrimin e ambienteve miqësore në përshtatje me nevojat e tyre përgjatë vizitave me prindërit e burgosur.
- ✓ Hartimi i një raporti vlerësues mbi "Të drejtat e fëmijës dhe përfshirja e aftësisë së kufizuar" i cili evidenton situatën e përfshirjes së të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar në agjendën e aftësisë së kufizuar dhe në atë të fëmijëve të qeverisjes lokale dhe qendrore si edhe të shoqërisë civile shoqëruar me disa rekomandime për adresimin e çështjeve të lidhura me gjithëpërfshirjen.
- ✓ Hartimi i një raporti vlerësues mbi Situatën e Zbatimit të të Drejtave të Fëmijëve në Bashkinë Tropojë i cili evidenton nivelin e të kuptuarit dhe ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve dhe zbatimin e tyre nga përfaqësues të qeverisjes vendore, prindër, të rinj dhe fëmijë me një fokus të veçantë në braktisjen e shkollës dhe martesën e hershme.
- ✓ Hartimi i manualeve për prindërit mbi prindërimin pozitiv për fëmijët 0-10 vjeç dhe 10-18 vjeç, të cilët ofrojnë informacion konkret, praktik dhe bashkëkohor si edhe shprehi shumë të nevojshme prindërimi në forma praktike, nëpërmjet rasteve, modeleve, ushtrimeve, këshillave dhe rekomandimeve konkrete.
- ✓ Hartimi i një manuali për prindërit dhe profesionistët i cili jep informacion ndihmues për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve ndaj ngacmimit dhe abuzimit seksual.
- ✓ Hartimi i një udhëzuesi për identifikimin dhe punën me viktimat e trafikimit, i cili ofron informacion të përgjithshëm për kuadrin ligjor, mekanizmat kryesorë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për viktimat e trafikimit si dhe përgatitjes së formateve specifike të intervistave për profesionistë që merren me identifikimin dhe referimin e rasteve të trafikimit (mjekë, punonjës socialë, psikologë dhe punonjës të policisë).
- ✓ Hartimi i një udhërrëfyese për menaxhimin e sjelljeve problematike të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe dokumentimin e tyre. Ky dokument iu vjen në ndihmë të gjithë profesionistëve në fushën e shërbimeve në aftësinë e kufizuar (veçanërisht edukatorëve dhe kujdestarëve) në ofrimin e një shërbimi sa më cilësor dhe profesional, duke përdorur metoda të standartizuara, dhe zbatuar teknika të ndërhyrjes për parandalimin dhe menaxhimin e sjelljes së fëmijëve me aftësi të kufizuar.
- ✓ Hartimi i një udhëzuesi për të rinjtë në sfidat parandaluese ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit i cili adreson çështje që shqetësojnë shoqërinë jo vetëm për mirërritjen dhe edukimin e të rinjve, por në nivel më të gjerë ndihmon dialogun dhe diskutimin, mendimin kritik, dhe garanton atmosferë gjithëpërfshirëse dhe tolerante.
- ✓ Përshtatja e manualit Kompasito në ndihmë të punonjësve të qendrave që ofrojnë shërbime për fëmijët në situatë rruge, për zhvillimin e aftësive dhe fuqizimin e fëmijëve të moshës 6-13 vjeç.

Ky botim publikohet në kuadër të projektit "Përfshirja e Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri" i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Terre des hommes.

Përmbajtja e kësaj fletëpalosje është përgjegjësi vetëm e Save the Children dhe Terre des hommes. Këndvështrimet e autorëve jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

#### **Terre des hommes Foundation Mission in Albania**

Rruga "Skënderbej", Nd. 8, H. 3,  
Ap. 27 & 37, Tirana, Albania

#### **Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri**

ABA Business Center, Rr. Papa Gjon  
Pali II, kati i 17-të, Tiranë – Albania  
Tel: (+355) 4 222 8320 or 223 0871/222 8479/223 4284  
Email: [delegation-albania@eeas.europa.eu](mailto:delegation-albania@eeas.europa.eu)  
<http://eeas.europa.eu/delegations/albania>

#### **Save the Children**

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7,  
ish Pallatet 1 Maji (Vila Lami);  
PO Box 8185, Tiranë, Albania  
Tel: +355 4 2261840 / 2261929

E-mail: [info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org)  
<https://albania@savethechildren.net>